



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MASH) NR. 86 /2020 PËR SISTEMIMIN E NXËNËSVE NË SHKOLLA, TË CILËT JANË
KTHYER PAS MIGRIMIT DHE U MUNGOJNË DOKUMENTET PËRKATËSE ARSIMORE

ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MES) NO . 86 / 2020 ON STUDENTS SYSTEMATIZATION IN SCHOOLS, WHICH ARE
RETURNED AFTER THE MIGRATION AND LACK RELEVANT EDUCATIONAL DOCUMENT

ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MON) BR . 86 / 2020 O SISTEMATIZACIJI UČENIKA KOJI SE VRAČU U ŠKOLAMA
NAKON MIGRACIJE I NEMAJU ODGOVARAJUĆA OBRAZOVNA DOKUMENTA

<p>Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 16 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës. (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 17, dt. 16 shtator 2011), nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Rregullores (QRK) nr. 6/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e dt. 06.06.2020, dhe nenit 4 të Rregullores (QRK) – nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) – nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, dt. 16.06.2020, nxjerr;</p> <p>UDHËZIM ADMINISTRATIV (MASH) NR. ____/2020 PËR SISTEMIMIN E NXËNËSVE NË SHKOLLA, TË CILËT JANË KTHYER PAS MIGRIMIT DHE U MUNGOJNË DOKUMENTET PËRKATËSE ARSIMORE</p>	<p>Minister of Education and Science, Pursuant to Article 5 paragraph 16 of Law no. 04 / L-032 on Pre-University Education in the Republic of Kosova. (Official Gazette of the Republic of Kosova, No. 17, 16 September 2011), Article 8 paragraph 1 under paragraph 1.4 of Regulation (NRC) no. 6/2020 on the areas of administrative responsibility of the Prime Minister's Office and the Ministries of 06.06.2020, and Article 4 of the Regulation (CRC) - no. 07/2020 on Amendment and Supplement of the Regulation (NRC) - no. 06/2020 for the Areas of Administrative Responsibility of the Prime Minister's Office and Ministries, dt. 16.06.2020, issue:</p> <p>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MES) NO . ____ / 2019 ON ON STUDENTS SYSTEMATIZATION IN SCHOOLS, WHICH ARE RETURNED AFTER THE MIGRATION AND LACK RELEVANT EDUCATIONAL DOCUMENT</p>	<p>Ministar obrazovanja i nauke, Na osnovu član 5 stav 16 Zakona br. 04/L032 o preduniverzitetskom obrazovanju Republike Kosovo. (Službeni glasnik Republike Kosovo, br. 17,16 septembra 2011), član 8 stav 1 podstav 1.4. Uredbe (VRK) br. 6/2020 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva dat. 06.06.2020 i član 4 Uredbe (VRK) - br. 07/2020 o izmenama i dopunama Uredbe (VRK) – br. 06/2020 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva, dat.16.06.2020, izdaje:</p> <p>ADMINISTRATIVNO UPUTTSTVO (MON) BR. ____/2019 O SISTEMATIZACIJI UČENIKA KOJI SE VRAČU U ŠKOLAMA NAKON MIGRACIJE I NEMAJU ODGOVARAJUĆA OBRAZOVNA DOKUMENTA</p>
<p>Neni 1 Qëllimi</p> <p>Me këtë Udhëzim administrativ, rregullohet sistemimi i nxënësve të cilët e kanë ndërprerë mësimin në njërin prej niveleve të arsimit, për shkak të migrimit jashtë Republikës së Kosovës dhe pas kthimitu mungojnë</p>	<p>Article 1 The purpose</p> <p>With this Administrative Instruction is regulated the students systematization who have stopped education at one of the education levels due to migration outside the Republic of Kosova and who lack relevant educational</p>	<p>Član 1 Cilj</p> <p>Ovim Administrativnim uputstvom reguliše se sistematizacija učenika koji su prekinuli obrazovanje na jednom od nivoa obrazovanja, zbog migriranje izvan Republike Kosovo i kojima posle povratka nedostaju odgovarajuća</p>

<p>dokumentet përkatëse arsimore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 2 Përkufizimet</p>	<p>documents after return.</p> <p style="text-align: center;">Article 2 Definitions</p>	<p>obrazovna dokumenta.</p> <p style="text-align: center;">Član 2 Definicije</p>
<p>1. Shkurtesat e përdorura në këtë Udhëzim administrativ kanë këto kuptime:</p> <p>1.1. DKA- Drejtoria Komunale e Arsimit; 1.2. MASH- Ministria e Arsimit dhe Shkencës; 1.3. KKK- Korniza e Kurrikulës e Kosovës. 1.4. SHFMU Shkolla fillore e mesme e ultë</p>	<p>1. The abbreviations used in this Administrative Instruction have these meanings:</p> <p>1.1. MED-Municipal Education Directorate; 1.2. MES–Ministry of Education and Science; 1.3. KCF –Kosova Curriculum Framework. 1.4. LPSSh Lower primary secondary school</p>	<p>1. Skraçenice koje se koriste u ovom Administrativnom uputstvu imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1. ODO - Opštinski direktorijat za obrazovanje 1.2. MON - Ministarstvo obrazovanja o nauke 1.3. OKK - Okvir kosovskog kurikuluma 1.4. ONSŠ Osnovna niža srednja škola</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Vazhdimi i mësimi</p> <p>1. Të gjithë nxënësve nga neni 1 i këtij Udhëzimi administrativ, u mundësohet vazhdimi i mësimi në shkollat ku kanë qenë të regjistruar më parë ose ku i përcakton DKA.</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Continuation of learning</p> <p>1. All students from Article 1 of this Administrative instruction are enabled to continue education in schools where they were previously enrolled or designated by the MED.</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Nastavak školovanja</p> <p>1. Svim učenicima iz član 1. ovog Administrativnog uputstva omogućava se nastavak školovanja u školama u kojima su bili prethodno upisani ili u školama koje odredi ODO.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 4 Dokumentacioni i nevojshëm</p> <p>1. Nxënësi duhet të dëshmojë që i përket kategorisë së nxënësve sipas neni 1 të këtij UA. 2. Nxënësi i cili ka vazhduar mësimin jashtë</p>	<p style="text-align: center;">Article 4 The necessary documentation</p> <p>1. The student must prove that he/she belongs to the category of students under Article 1 of this AI. 2. A student who has continued teaching</p>	<p style="text-align: center;">Član 4 Potrebna je dokumentacija</p> <p>1. Učenik mora da dokaže da pripada kategoriji učenika prema člana 1 ovog AU. 2. Učenik koji je nastavio školovanje u</p>

<p>vendit, duhet ta sjellë certifikatën - dëshminë nga shteti në të cilin i ka ndjekur mësimet dhe dokumentet që dëshmojnë se ka qenë nxënës në Kosovë.</p>	<p>abroad must bring a certificate - evidence from the state in which he or she has attended lessons and documents proving that they were students in Kosova.</p>	<p>inostranstvu, mora da dostavi certifikat - dokaz iz zemlje u kojoj je pohađao nastavu i dokumenta kojom dokazuje da je bio učenik na Kosovu</p>
<p>3. Nxënësi i cili nuk sjellë dëshmi që ka vazhduar shkollimin jashtë vendit, u nënshtrohet provimeve të klasës, apo mësimit të individualizuar, varësisht nga periudha e mosvrijimit të mësimit dhe moshës që ka.</p>	<p>3. A student who does not bring proof for continuation of education abroad is subject to class examinations or individualized learning, depending on the period of non-attendance and age it has.</p>	<p>3. Učenik koji ne dostavi dokaz da je školovanje nastavio van zemlje, polagaće razredne ispite, ili individualizovana nastava, u zavisnosti od period ne pohađanje nastave i starosnoj dobi.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 5 Vlerësimi i nxënësit për arsimin fillor (klasat 1-5)</p>	<p style="text-align: center;">Article 5 Student Assessment for Primary Education (Grades 1-5)</p>	<p style="text-align: center;">Član 5 Ocenjivanje učenika za osnovno obrazovanje (razred 1-5)</p>
<p>1. Nxënësi me t'u kthyer në Kosovë, i paraqet shkollës kërkesë për vazhdimin e mësimit dhe vlerësimin të të arriturave.</p> <p>2. Shkolla obligohet të ofroj mësim plotësues.</p> <p>3. Nëse nxënësi e ka ndërprerë mësimin në tremujorin e parë, vazhdon mësimin në klasën përkatëse.</p> <p>4. Nëse nxënësi e ka ndërprerë mësimin në tremujorin e dytë dhe në tremujorin e tretë, i nënshtrohet vlerësimin të komisionit:</p> <p>4.1. Komisionin e formon Drejtori i shkollës në përbërje të: mësimdhënësit të klasës, një përfaqësuesi të aktivitetit dhe bashkëpunëtorit profesional. Kryetar i komisionit është</p>	<p>1. Upon return to Kosova, student submits request to school for continuing learning and assessment of achievements.</p> <p>2. The school is obliged to provide additional learning.</p> <p>3. If the student has stopped learning in the first three months, he or she will continue in the relevant class.</p> <p>4. If the student has stopped learning in the second trimester and in the third trimester, he / she is subject to commission evaluation.</p> <p>4.1. The Commission is formed by the School Principal, consisted of: a classroom teacher, a representative of the asset, and a professional associate. The chair of the</p>	<p>1. Učenik nakon povratak na Kosovo, podnosi zahtev školi za nastavak školovanja i ocenjivanje postignuće.</p> <p>2. Škola je obavezna da omogući dopunsku nastavu</p> <p>3. Ako je učenik prekinuo nastavu u prvo tromesečje, nastaviće da pohađa nastavu u dotični razred.</p> <p>4. Ako je učenik prekinuo nastavu u drugo i treće tromesečje, podleže ocenjivanje od strane komisije</p> <p>4.1. Komisiju formira direktor škole, sastavljenu od: razrednog nastavnika, predstavnik aktivnosti, i stručni saradnici. Predsednik komisije je razredni nastavnik.</p>

<p>mësimdhënësi i klasës;</p> <p>4.2. Komisioni vlerëson të arriturat e nxënësit dhe jep rekomandime për planin individual të tij;</p> <p>4.3. Komisioni harton instrumentet e vlerësimit.</p> <p>5. Nëse nxënësi ka munguar deri në 2 vite shkollë, i nënshtrohet vlerësimit të njohurive përmbljedhëse (të dy vite së bashku) nga komisioni sipas nenit 5.4.1.</p> <p>5.1 Komisioni vlerëson të arriturat e nxënësit, noton nxënësin për klasën përkatëse dhe jep rekomandime sipas nenit 5, nënparagrafi 4.2 dhe 4.3.</p>	<p>commission is the classroom teacher.</p> <p>4.2. The commission evaluates the student's achievements and makes recommendations for its individual plan.</p> <p>4.3. The Commission compiles the evaluation instruments.</p> <p>5. If the student has been absent for up to 2 school years, he / she is subject to assessment of summary knowledge (for both years) by the commission under Article 5.4.1.</p> <p>5.1. The Commission evaluates the student achievements, grades the student for the respective class and makes recommendations in accordance with Article 5, subparagraphs 4.2 and 4.3.</p>	<p>4.2. Komisija ocenjuje dostignuće učenika i daje preporuke za njegov individualni plan</p> <p>4.3. Komisija sastavlja instrumente ocenjivanja</p> <p>5. Ako je učenik odsustvovao od nastave do 2 školske godine, u tom slučaju on/ona podleže proceni sažetog znanja (za obe godine zajedno) od strane komisije u skladu sa članom 5.4.1.</p> <p>5.1 Komisija procenjuje dostignuće učenika, ocenjuje učenika za dotični razred i daje preporuke u skladu sa član 5, podstav 4.2 i.4.3.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 6</p> <p style="text-align: center;">Vlerësimi i nxënësit dhe provimet e klasës për arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9)</p>	<p style="text-align: center;">Article 6</p> <p style="text-align: center;">Student assessment and class exams for lower secondary education (grades 6-9)</p>	<p style="text-align: center;">Član 6</p> <p style="text-align: center;">Ocenjivanje učenika i razredni ispiti za niže srednje obrazovanje (razred 6-9)</p>
<p>1. Nxënësi, me t'u kthyer në Kosovë, i paraqet shkollës kërkesë për vazhdimin e mësimin dhe për t'iu nënshtruar provimit të klasës sipas nevojës.</p> <p>2. Shkolla obligohet të ofroj mësim plotësues për nxënësin.</p>	<p>1. Upon return to Kosova, the student submits a request to the school to continue learning and to take the class exam as required.</p> <p>2. The school is obliged to provide additional learning to the student.</p>	<p>1. Učenik nakon povratka na Kosovo, podnosi zahtev školi za nastavak školovanja i da polaže razredni ispit prema potrebi.</p> <p>2. Škola je obavezna da omogući dopunsku nastavu učeniku.</p>

<p>3. Nëse nxënësi e ka ndërprerë mësimin në tremujorin e parë, vazhdon mësimin në klasën përkatëse.</p> <p>4. Nëse nxënësi e ka ndërprerë mësimin në tremujorin e dytë, vazhdon mësimin në klasën përkatëse dhe i nënshtrohet vlerësimit të komisionit:</p> <p>4.1. Komisionin e formon drejtori i shkollës, në përbërje të përfaqësuesve të 7 fushave mësimore. Kryetar i komisionit është kujdestari i klasës;</p>	<p>3. If the student has stopped learning in the first three months, he or she will continue in the relevant class.</p> <p>4. If the student has stopped learning in the second trimester, he or she continues learning in the relevant class and is subject to commission evaluation.</p> <p>4.1. The Commission is formed by the School Principal, consisting of representatives of 7 teaching areas. The chair of the commission is the class warden.</p>	<p>3. Ako je učenik prekinuo nastavu u prvo tromesečje, nastaviće će nastavu u dotični razred.</p> <p>4. Ako je učenik prekinuo nastavu u drugo tromesečje, nastavlja nastavu u dotični razred i podleže ocenjivanju od strane komisije.</p> <p>4.1. Komisiju formira direktori škole, u sastav predstavnika 7 obrazovnih oblasti. Predsednik komisije je razredni starešina.</p>
<p>4.2. Komisioni vlerëson të arriturat e nxënësit sipas nenit 5, nënparagrafi 4.2 dhe 4.3.</p> <p>5. Nëse nxënësi e ka ndërprerë mësimin në tremujorin e tretë, vazhdon mësimin në klasën përkatëse si dëgjues dhe i nënshtrohet provimit klasor nga komisioni sipas nenit 6, nënparagrafi 4.1 dhe nenit 5, nënparagrafi 4.2 dhe 4.3.</p>	<p>4.2. The Commission assesses student achievement under Article 5, subparagraphs 4.2 and 4.3.</p> <p>5. If the student has stopped learning in the third trimester, he or she continues learning in the relevant classroom as a listener and is subject to the class exam by the commission under Article 6, subparagraph 4.1 and Article 5, subparagraphs 4.2 and 4.3.</p>	<p>4.2. Komisija ocenjuje dostignuće prema član 5, podstav 4.2 i 4.3</p> <p>5. Ako je učenik prekinuo nastavu u trećem tromesečju, nastavlja sa nastavom u dotični razred da sluša i polagaće razredni ispit pred komisiju prema člana 6 podstav 4.1 i članom 5. podstavkom 4.2 i 4.3.</p>
<p>6. Nëse nxënësi e ka ndërprerë mësimin për 1 vit shkollor e deri në fund të periudhës së parë të vitit pasues shkollor, vazhdon mësimet në klasën vijuese dhe i nënshtrohet provimeve të klasës paraprake nga komisioni sipas nenit 6, nënparagrafi 4.1.</p>	<p>6. If the student has stopped learning for one school year until the end of the first period of the following school year, he / she continues learnings in the subsequent class and is subject to exams of the previous class by the commission under Article 6, sub-paragraph 4.1.</p>	<p>6. Ako je učenik prekinuo da pohađa nastavu 1 školsku godinu pa sve do kraj prvog perioda sljedeće školske godine, nastavlja da pohađa nastavu u sljedećem razredu i polagaće ispite iz prethodnog razreda, od strane komisije prema član 6. podstav 4.1.</p>
<p>6.1. Komisioni vlerëson të arriturat e nxënësit dhe konstaton se a ka njohuri të</p>	<p>6.1. The Commission assesses the student's achievements and ascertains whether he or</p>	<p>6.1. Komisija ocenjuje dostignuće učenika i utvrđuje dali ima dovoljno znanja za</p>


<p>mjaftueshme të vijoj klasën përkatëse, apo duhet të përsëritë klasën duke u bazuar në instrumentet sipas nenit 5, nënparagrafi 4.3.</p>	<p>she has sufficient knowledge to continue with the relevant class, or whether to repeat the class on the basis of the instruments according to in Article 5, subparagraph 4.3.</p>	<p>pohađa dotični razred, ili treba da ponovi razred bazirajući se na instrumente prema član 5. podstav 4.3.</p>
<p>6.2. Afatin e provimit e cakton drejtori i shkollës gjatë periudhës së dytë të vitit shkollor.</p>	<p>6.2. The exam period is set by the school principal during the second period of the school year.</p>	<p>6.2. Rok ispita određuje direktor škole tokom drugog perioda školske godine.</p>
<p>7. Nëse nxënësi e ka ndërprerë mësimin për 1 vit shkollor dhe kthehet gjatë periudhës së dytë deri në mars të vitit pasues shkollor, u nënshtrohet provimeve klasore të klasës paraprake. Nxënësi vijon mësimet si dëgjues për klasën vijuese dhe vlerësohet në fund të vitit shkollor për klasën vijuese nga komisioni sipas nenit 6, nënparagrafi 4.1.</p>	<p>7. If the student has interrupted lessons for one school year and returns during the second period until March of the subsequent school year, he / she is subject to exams of the previous class. The student attends lessons as a listener for the following class and is assessed at the end of the school year for the following class by the commission in accordance with Article 6, subparagraph 4.1.</p>	<p>7. Ako je učenik prekinuo da pohađa nastavu 1 školsku godinu i vrati se u drugi period do marta sljedeće školske godine, polagaće razredne ispite iz prethodni razred. Učenik pohađa nastavu kao slušatelj za naredni razred i ocenjuje se na kraju školske godine za sljedeći razred od strane komisije u skladu sa članom 6, podstavkom 4.1.</p>
<p>7.1 Komisioni vlerëson të arriturat e nxënësit dhe konstaton se a ka njohuri të mjaftueshme të vijoj klasën përkatëse, apo duhet të përsëritë klasën duke u bazuar në instrumentet sipas Nenit 5, nënparagrafi 4.3.</p>	<p>7.1. The Commission assesses the student's achievements and ascertains whether he or she has sufficient knowledge to attend the relevant class, or whether should repeat the class on the basis of the instruments referred to in Article 5, subparagraph 4.3.</p>	<p>7.1 Komisija ocenjuje dostignuće učenika i utvrđuje dali ima dovoljno znanja za pohađa dotični razred, ili treba da ponovi razred bazirajući se na instrumente prema član 5. podstav 4.3.</p>
<p>8. Nxënësi i cili nuk ka vijuar mësimet e klasës së 9-të, vijon mësimet në klasën e dhjetë, në shkollën të cilën e përcakton DKA.</p>	<p>8. A student who has not attended the 9th grade lessons, attends the tenth grade lessons in the school that is set by MED.</p>	<p>8. Učenik koji nije pohađao nastavu 9-tog razreda pohađaće 10-ti razred u školi koju odredi ODO.</p>
<p>8.1 SHFMU ku ka vijuar mësimin, organizon provimet për klasën e 9-të deri në fund të tetorit.</p>	<p>8.1. The LPSSch where he/she has been attending classes organizes exams for 9th grade until the end of October.</p>	<p>8.1 ONSŠ gde je pohađao nastavu organizuje ispite za 9-ti razred do kraja oktobra.</p>

<p>8.2 Testi i arritshmërisë organizohet gjatë muajit tetor në bashkëpunim me MASH dhe DKA.</p> <p>9. Nxënësi i cili ka kaluar moshën e shkollimit të rregullt, mësimet i vazhdon në arsimin për të rriturit sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Vlerësimi i nxënësit dhe provimet e klasës për arsimin e mesëm të lartë (klasat 10-12)</p>	<p>8.2. The achievement test is organized during October in cooperation with MES and MED.</p> <p>9. A student who has reached the age of regular education continues its education in adult education under the legislation in force.</p> <p style="text-align: center;">Article 7 Student assessment and class examinations for higher secondary education (grades 10-12)</p>	<p>8.2 Test dostignuća organizuje se oktobra meseca u saradnji sa MON i ODO.</p> <p>9. Učenik koji je prešao starosnu dobu za školovanje, nastavu će pohađati u obrazovanju za odrasle prema zakonodavstvu na snazi.</p> <p style="text-align: center;">Član 7 Ocenjivanje učenika i razredni ispiti za više srednje obrazovanje (10-12 razred)</p>
<p>1. Nxënësi me t'u kthyer në Kosovë, i paraqet shkollës kërkesë për vazhdimin e mësimit dhe për t'iu nënshtruar provimit të klasës sipas nevojës.</p> <p>2. Shkolla obligohet të ofroj mësim plotësues.</p> <p>3. Nëse nxënësi e ka ndërprerë mësimin në tremujorin e parë, vazhdon mësimin në klasën përkatëse.</p> <p>4. Nëse nxënësi e ka ndërprerë mësimin në tremujorin e dytë, vazhdon mësimin në klasën përkatëse dhe i nënshtrohet vlerësimit të komisionit.</p> <p>4.1. Komisionin e formon drejtori i shkollës sipas nenit 6.4.1, 5.4.2 dhe 5.4.3</p>	<p>1. Upon return to Kosova, the student submits a request to the school to continue lessons and is subject to class exam as required.</p> <p>2. The school is obliged to provide additional learning.</p> <p>3. If the student has stopped learning in the first three months, he or she will continue in the relevant class.</p> <p>4. If the student has stopped learning in the second trimester, he or she continues learning in the relevant class and is subject to commission evaluation.</p> <p>4.1. The Commission shall be established by the School Principal in accordance with Article 6.4.1, 5.4.2 and 5.4.3.</p>	<p>1. Učenik nakon povratak na Kosovo, podnosi zahtev školi za nastavak školovanja i da polaže razredni ispit.</p> <p>2. Škola je obavezna da omogući dopunsku nastavu</p> <p>3. Ako je učenik prekinuo nastavu u prvo tromesečje, nastaviće da pohađa nastavu u dotični razred.</p> <p>4. Ako je učenik prekinuo nastavu u drugo tromesečje, nastavlja da sluša nastavu u dotični razred i podleže ocenjivanje od strane komisije.</p> <p>4.1. Komisiju formira direktor škole prema član 6.4.1, 5.4.2. i 5.4.3</p>

<p>5. Nëse nxënësi e ka ndërprerë mësimin në tremujorin e tretë, vazhdon mësimin si dëgjues në klasën përkatëse dhe i nënshtrohet provimit klasor para komisionit sipas nenit 6, nënparagrafi 4.1 dhe nenit 5, nënparagrafi 4.2 dhe 4.3.</p>	<p>5. If the student has stopped learning in the third trimester, he or she continues learning in the relevant classroom as a listener and is subject to the class exam before the commission under Article 6, subparagraph 4.1 and Article 5, subparagraphs 4.2 and 4.3.</p>	<p>5. Ako je učenik prekinuo nastavu u trećem tromesečju, nastavlja sa nastavu da sluša u dotični razred i polagaće razredni ispit pred komisijom prema član 6 podstav 4.1 i članom 5. podstav 4.2 i 4.3.</p>
<p>6. Nxënësi i cili ka qenë i regjistruar, por nuk ka vijuar mësimin fare, vazhdon mësimin si dëgjues në klasën përkatëse dhe i nënshtrohet provimit klasor para komisionit sipas nenit 6, nënparagrafi 4.1 dhe nenit 5, nënparagrafi 4.2 dhe 4.3.</p>	<p>6. If the student who has been enrolled but did not attended lessons at all, continues learning as listener in the relevant class and is subject of the class exam before the commission accordig to Article 6, sub-paragraph 4.1 and Article 5, sub-paragraph 4.2. and 4.3.</p>	<p>6. Učenik koji je bio upisan ali nije pohađao nastavu uopšte, nastavlja da sluša nastavu dotični razred i polagaće razredni ispit pred komisijom prema član 6 podstav 4.1 i član 5. podstav 4.2 i 4.3.</p>
<p>7. Nëse nxënësi e ka ndërprerë mësimin për 1 vit shkollor e deri në fund të tetorit të vitit pasues shkollor, i nënshtrohet provimit të klasës paraprake gjatë periudhës së parë të kalendarit të vitit shkollor. Nxënësi vazhdon mësimet në klasën vijuese dhe vlerësohet si nxënës i rregullt sipas nenit 6, nënparagrafi 4.1 dhe nenit 5, nënparagrafi 4.2 dhe 4.3.</p>	<p>7. If the student has stopped learning for one school year up to the end of October of the subsequent school year, is subject to the previous class exam during the first period of the school year calendar. The student attends lessons as a listener for the following class and is assessed as regular student according to Article 6, subparagraph 4.1 and Article 5, subparagraph 4.2 and 4.3.</p>	<p>7. Ako je učenik prekinuo da pohađa nastavu 1 školsku godinu do kraja oktobra sljedeće školske godine, polagaće ispit iz prethodnog razreda tokom prvog kalendarskog perioda školske godine. Učenik nastavlja sa nastavom u sljedeći razred i ocenjuje se kao redoviti učenik prema članu 6, podstav 4.1 i članu 5, podstav 4.2 i 4.3.</p>
<p>8. Nëse nxënësi e ka ndërprerë mësimin për 1 vit shkollor dhe kthehet nga nëntori deri në mars të vitit pasues shkollor, u nënshtrohet provimeve klasore të klasës paraprake. Nxënësi vijon mësimet si dëgjues për klasën vijuese dhe vlerësohet në fund të vitit shkollor për klasën vijuese sipas nenit 6, nënparagrafi 4.1.</p>	<p>8. If the student has stopped learning for one school year and returns during from Novemeber until March of the subsequent school year, he / she is subject to exams of the previous class. The student attends lessons as a listener for the following class and is assessed at the end of the school year for the following class according to Article 6, subparagraph 4.1.</p>	<p>8. Ako je učenik prekinuo da pohađa nastavu 1 školsku godinu i vrati se u period od novembra do marta meseca naredne školske godine, polagaće razredne ispите iz prethodni razred. Učenik pohađa nastavu kao slušatelj za naredni razred i ocenjuje se na kraju školske godine za sljedeći razred u skladu sa članom 6, podstav 4.1.</p>
<p>8.1. Komisioni vlerëson të arriturat e nxënësit dhe konstaton se a ka njohuri të</p>	<p>8.1. The Commission assesses the student's achievements and ascertains whether he or</p>	<p>8.1. Komisija ocenjuje postignuće učenika i utvrđuje dali ima dovoljno znanja da pohađa</p>

<p>mjaftueshme të vijoj klasën përkatëse, apo duhet të përsëritë klasën, duke u bazuar në instrumentet sipas nenit 5, nënparagrafi 4.3.</p>	<p>she has sufficient knowledge to attend the relevant class, or whether to repeat the class on the basis of the instruments referred to in Article 5, subparagraph 4.3.</p>	<p>dotični razred, ili treba da ponovi razred bazirajući se na instrumente prema član 5. podstav 4.3.</p>
<p>9. Nëse nxënësi e ka ndërprerë mësimin për 1 vit shkollor dhe kthehet gjatë tremujorit të fundit të vitit pasues shkollor, mësimet i vazhdon në arsimin për të rriturit sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>10. Nëse nxënësi ka humbur mësim 2 vite e më shumë, mësimet i vazhdon në arsimin për të rriturit, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>11. Nxënësve të shkollave profesionale të regjistruar si vijues duhet t'u sigurohet praktika profesionale.</p>	<p>9. If a student has stopped learning for 1 school year and returns during the last three months of the subsequent school year, he or she shall continue their education in adult education under the legislation in force.</p> <p>10. If a student has missed lessons for 2 or more years, he or she continues its lessons in adult education under the legislation in force.</p> <p>11. Students of vocational schools enrolled as attendee should be provided with professional internships</p>	<p>9. Ako je učenik prekinu nastavu 1 školsku godinu i vrati se u period poslednjeg tromesečja naredne školske godine, nastavu će nastaviti da pohađa u nastavi za odrasle prema zakonodavstvu na snazi.</p> <p>10. Učenik koji je izgubio 2 i više godine, nastavu će pohađati u nastavi za odrasle prema zakonodavstvu na snazi.</p> <p>11. Učenicima profesionalnih škola koji su upisani kao kandidati koji će pohađati mora da im se obezbediti profesionalna praksa.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 8 Organizimi i provimeve</p>	<p style="text-align: center;">Article 8 Organizing exams</p>	<p style="text-align: center;">Član 8 Organizovanje ispita</p>
<p>1. Afati i provimeve organizohet për grup nxënësish ose veç e veç, varësisht nga numri i tyre.</p> <p>2. Provimet klasore nuk paguhen.</p>	<p>1. Exam deadlines are organized per group of students or individually, depending on their number.</p> <p>2. Class exams are not paid.</p>	<p>1. Ispitni rok se organizuje za grupu učenika ili posebno za svakog, u zavisnosti od njihovog broja.</p> <p>2. Razredni ispiti se ne plaća.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9 Procesverbali i provimeve klasore</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Minutes of class exams</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Zapisnik razrednih ispita</p>

<p>1. Procesverbalin e udhëheq mësimeve në fillim të orës së mësimi i klasës për arsimin fillor dhe kujdestari i klasës për arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë.</p>	<p>1. The minute is managed by the class teacher for primary education and the class warden for lower secondary and higher secondary education.</p>	<p>1. Zapisnik vodi razredni nastavnik za osnovno obrazovanje i razredni starešina za niže srednje obrazovanje.</p>
<p>2. Procesverbali shënohet në fund të ditarit në fletët "Shënime tjera" ose në fletë të tjera të lira.</p>	<p>2. The minute is written at the end of the diary on sheets "Other Notes" or in other blank sheets.</p>	<p>2. Zapisni se vodi na kraju dnevnika na stranici "Druge beleške" ili drugi prazan list</p>
<p>3. Në fillim të procesverbalit, citohet Udhëzimi administrativ i cili e mundëson provimin e klasës.</p>	<p>3. At the beginning of the minute is cited: Administrative Instruction which enables the class exam.</p>	<p>3. Na početak zapisnika navodi se Administrativno uputstvo koje omogućava razredni ispit.</p>
<p>4. Në procesverbal shënohen lëndët mësimore, sipas planprogrameve mësimore të klasës përkatëse.</p>	<p>4. Teaching subjects according to the curricula of the respective class are written in the minutes.</p>	<p>4. U zapisnik se upisuje nastavni predmet, prema nastavnim planom relevantnog razreda.</p>
<p>5. Në fund të procesverbalit anëtarët e komisionit shënojnë emrin, mbiemrin dhe nënshkruajnë procesverbalin.</p>	<p>5. At the end of the minutes, the members of the commission write down the name, surname and sign the minutes.</p>	<p>5. Na kraju zapisnika članovi komisije upisuju ime, prezime i potpisuju zapisnik.</p>
<p>Neni 10 Notat</p>	<p>Article 10 Grades</p>	<p>Član 10 Ocene</p>
<p>1. Notat shënohen në procesverbal sipas KKK. Lista e lëndëve dhe e notave në procesverbal duhet të përputhet si në dëftesë.</p>	<p>1. The grades are marked in minutes according to KCF. Subject and the grade list in minutes must match as in the certificate.</p>	<p>1. Ocene se upisuju u zapisnik prema OKK. Spisak predmeta i ocena u zapisnik se moraju uklapati kao u svedočanstvo.</p>
<p>2. Notat shënohen në ditarin e klasës përkatëse.</p>	<p>2. The grades are marked in the relevant class diary.</p>	<p>2. Ocene se upisuju u dnevnik dotičnog razreda</p>
<p>3. Në ditar, në faqet e suksesit të nxënësve, shënohen vetëm notat përfundimtare me të kuqe dhe barten në Librin amë.</p>	<p>3. In the diary, in pages of student success are marked only final grades in red and are transferred into the matrix book.</p>	<p>3. U dnevnik, na stranici u vezi uspeh učenika, upisuje se samo završna ocena crvenom bojom i prenosi se u Matičnu knjigu</p>

<p>4. Libri amë plotësohet si për nxënësit të cilët e kanë vijuar mësimin me rregull, vetëm se duhet të referohet Udhëzimi administrativ.</p>	<p>4. The matrix book is completed for students who have attended regular classes, only the administrative instruction should be referred.</p>	<p>4. Matična knjiga se vodi kao za učenike koji su pohađali redovno školovanje, samo mora biti podržano Administrativnim uputstvom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 11 Dispozitat shfuqizuese</p> <p>Me hyrjen në fuqi të këtij UA, shfuqizohet UA, nr. 19/2015 dt. 16.2015.</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Repealing provisions</p> <p>With the entry into force of this AI, AI No. 19/2015 dated 16.2015 is repealed.</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Vansnažne odredbe</p> <p>Stupanjem na snagu ovog AU, stavlja se van snage AU, br. 19/2015 dat.16.2015.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 12 Hyrja në fuqi</p> <p>Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri.</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 Entry into force</p> <p>This Administrative Instruction shall enter into force seven (7) days after being signed by the Minister.</p>	<p style="text-align: center;">Član 12 Stupanje na snagu</p> <p>Ovo Administrativno Uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana nakon potpisivanja od strane Ministra.</p>
<p style="text-align: center;"> Ramë Likaj Ministër</p> <p>Datë: _____</p>	<p style="text-align: center;">Ramë Likaj Minister</p> <p>Date: ____ / ____ / ____</p>	<p style="text-align: center;">Ranë Likaj Ministar</p> <p>Dat: ____ / ____ / ____</p>

--	--	--



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:		Ramë Likaj, Minister /MASH <i>Raj</i>			
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:		Agim Bërdyna, u.d. sekretar i përgjithshëm /MASH			
NGA/OD/FROM:		Fadile Dyla drejtore, DIEKPÇL <i>Fadile Dyla</i> Elhame Shabani, zyrtare e lartë ligjore <i>Elhame Shabani</i>			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Dërgimi i draftudhëzimit administrativ për nënshkrim: U.A. Për Sistemimin e nxënësve në shkolla, të cilët janë kthyer pas migrimit dhe u mungojnë dokumentet përkatëse arsimore			
Nr. i zyrës:	211	Lokacioni:	MASHT	Data:	02.07.2020
Br. Kancelarije:	20 105	Kucni:		Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS					
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

I nderuar,

Bashkangjitur shkresës gjeni draftudhëzimin administrativ “Për Sistemimin e nxënësve në shkolla, të cilët janë kthyer pas migrimit dhe u mungojnë dokumentet përkatëse arsimore”, Gjithashtu ju njoftoj se në bazë të njoftimit nga iniciuesi i hartimit të tij ky draftudhëzim e ka kaluar konsultimin paraprak dhe diskutimin publik.

Me respekt!